




KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: <u>27-02</u> 20 <u>20</u>		
Primjeto:		
Nr. Jodritica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
<u>1-352</u>	<u>11985</u>	



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

E lidhur në LIPJAN me datë 26.02 2020, ndërmjet :

Komunës së Lipjanit , përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit (në vazhdim të tekstit Komuna) dhe

Kompanisë Rajonale të Ujësjetllësit SH.A Prishtina “, Prishtinë rr. Hazir Shala nr.4 përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Ilir Avdullahu (në vazhdim të tekstit Kompania)

Neni 1 Qëllimi

1.Qëllimi i lidhjes së këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është bashkëfinancimi i përbashkët për Projektin “Hapja e 5 (pesë) puseve për furnizimi me ujë të pijshëm të burimeve nëntokësore në lokacionet ekzistuese NJOU Lipjan”

2.Shuma e terësishme e bashkëfinancimit është 65.000 € (gjashtëdhjetë e pesë mijë euro) .

Neni 2 Obligimet e Komunës

1. Komuna me anë të këtij Memorandumi merr obligim të participojë- bashkëfinancojë me 51 % të vlerës së terësishme të investimit.
2. Shuma e cekur në par. 1 të këtij neni, do të ndahet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit - kategoria ekonomike - fondi për bashkëfinancim me donatorë.

Neni 3 Obligimet e Kompanisë

1. Me anë të kësaj marrëveshje, Kompania merr obligim të participojë- bashkëfinancojë me 49% të shumës së investimit të këtij Memorandumi.

2. Kompania do të hartojë projektin detal dhe i njëjti do të aprovohet nga subjektet e këtij Memorandumi.

Neni 4 **Zhvillimi i procedurave të prokurimit**

Procedurat e prokurimit do të zhvillohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, të cilat do të udhëhiqen nga Komuna e Lipjanit dhe në procesin e përzgjedhjes do të jetë një Komision i përbashkët nga Komuna dhe Kompania.

Neni 5 **Mënyra e ekzekutimit të pagesës**

Pjesa e parë e pagesës përkatësisht 51% e shumës do të ekzekutohet nga Komuna ndërsa pjesa e dytë e pagesës 49% e vlerës investimit do të ekzekutohet nga Kompania

Neni 6 **Ndryshimi dhe Përfundimi**

1. Ky Memorandum Mirekuptimi mund te ndryshohet vetem me shkrim.
2. Ky Memorandum Mirekuptimi mund te jete zgjidhur nga çdo palë me kushtin qe të njoftojë palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë perpara.

Neni 7 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palet do te përpiqen te zgjidhin në mënyrën me të përshtatshme çdo mosmarrëveshje qe buron nga ky Memorandum Mirekuptimi.

Neni 8 **Hyrja në fuqi**

1. Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

Z. Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës së Lipjanit



Z. Ilir Avdullahu
Kryeshf Ekzekutiv i i KUR "Prishtina" sh.a

